REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVES
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
Hajvali - Prishtinë
01-02-1280/2
Data / Datum 14.12.2023

Prishtinë, 14.12.2023

Kryeshefi Ekzekutiv në Inspektoratin Policor të Kosovës bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës nenin 12 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2. lidhur me nenin 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Kryeshefi Ekzekutiv nxjerr këtë:

# VENDIM

I. Miratohet plani i integritetit i hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me Vendimin Nr.01-02-1280/1, të datës 04.10.2023.

II. z. Exhevit Zuka, u.d. Udhëheqës i Departamentit për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

## *Arsyetim*

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022),në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 14.12.2023 Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës nxjerr vendim për miratimin e Planit të Integritetit, të hartuar nga grupi punues, i caktuar me Vendim nr. 01-02-1280/1 më datë 04.102.2023, të theksuar si në pikën 1 të dispozitivit të Vendimit.

z. Exhevit Zuka sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, i cili monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Kushtrim HODAJ**

Kryeshef Ekzekutiv

Inspektorati Policor I Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- Anëtareve të Grupit Punues,
- z. Exhevit Zuka,
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA · POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
Nr./Br. 01-02-1280/2
Data/Datum 14-12-2023

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvounutrasnjihposlova
Ministry of Internal Affairs

Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo

# PLANI I INTEGRITETIT 2024- 2026

| | |
|---|---|
| **Institucioni** | **INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS** |
| **Titulli** | **PLANI I INTEGRITETIT 2024-2026** |
| **Njësia hartuese** | **Grupi punues për hartimin e Planit të Integritetit i caktuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK** |
| **Numri** | **01 / 2023 – IPK** |
| **Data e aprovimit** | **14.12.2023** |
| **Autoriteti miratues** | **Kushtrim Hodaj**<br>**Kryeshef Ekzekutiv**<br>**Inspektorati Policor i Kosovës** |

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

# INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
Hajvali - Prishtinë
Nr./Br. 01-02-1280/2
Data/Datum 14.12.2023

# PLANI I INTEGRITETIT
# 2024-2026

Prishtinë, 2023

PËRMBAJTJA:

PARATHËNIE ..... 03

Shkurtesat ..... 05

HYRJE ..... 06

1. Për Inspektoratin Policor të Kosovës ..... 07

2. Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve ..... 08

   2.1. Fushat e përbashkëta të rrezikut ..... 08

   2.2. Fushat specifike të rrezikut ..... 13

3. Masat për evitimin dhe tejkalimin e rreziqeve ..... 21

Shtojcë - Plani i veprimit ..... 22

**PARATHËNIE**

IPK është institucion i mbikëqyrjes policore me një shkallë të theksuar të besueshmërisë së publikut. Kjo paraqet një vlerë kur kihet parasysh se i tërë shërbimi realizohet për të përmbushur nevojat dhe pritjet e qytetarëve. Të jesh i besueshëm për publikun nuk është gjë e lehtë, sidomos në kohën kur shumë institucione përballen me rreziqe të rënies së integritetit. Por kjo nuk nënkupton se nuk ka përpjekje për të përmirësuar kualitetin e menaxhimit dhe duke evituar korrupsionin.

Duke besuar se integriteti është themel i çdo sistemi të mirëqeverisjes, duhet kujdesur që brenda organizatës gjithnjë të vijnë në shprehje vlerat si: llogaridhënia, transparenca, rezistenca ndaj korrupsionit, ndershmëria, efikasiteti dhe profesionalizmi. Ikja nga këto vlera e bën organizatën të ekspozuar ndaj rreziqeve, që mund të kenë efekte negative në përmbushjen me sukses të objektivave, por edhe misionit të organizatës.

Është një shqetësim dhe fakt se humbja e integritetit fillon me plasaritje të vogla dhe kjo nënkupton që sado i ulët që të jetë rreziku i rënies së integritetit, duhet ndërmarrë masa konkrete për ta sanuar atë. Kur kemi parasysh se organizata jonë ka mandat të luftimit të korrupsionit dhe keq menaxhimit në radhët e Policisë së Kosovës, shtrohet nevoja për ndjekje të standardeve të larta të sjelljes personale dhe organizative.

Duke qenë i interesuar në zhvillimin e një mekanizmi mbikëqyrës me integritet dhe në përmbushje të obligimit për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet që synojnë të cenojnë integritetin e organizatës, është iniciuar procesi i nxjerrjes së një Plani të Integritetit, i cili nga një ekip ekspertësh ka propozuar edhe masat për evitimin e rreziqeve të mundshme. Ky Plan synon të parandaloj çdo rrezik të mundshëm, që ka në fokus pengimin e zhvillimit normal të organizatës.

Menaxhimi i rrezikut të integritetit përfshinë adresimin në mënyrë sistemore të rreziqeve nëse këto sfidojnë strukturën dhe funksionet organizative, me qëllimin final të fuqizimit të rezistencës ndaj korrupsionit. IPK nuk do të injorojë rreziqet sado të vogla që të jenë, por ka gatishmërinë dhe përkushtimin që masat e duhura të propozuara t'i vë në funksion në ruajtjes së integritetit. Sa më e egër që të jetë rezistenca jonë në ruajtje të vlerave etike, aq më i dobët do të jetë ndikimi i rreziqeve që sfidojnë integritetin.

Ruajtja e integritetit ka qëllim shmangien e konfliktit të interesit, parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, trajtimin e duhur të informacionit zyrtar, shfrytëzimin e drejtë të autoritetit zyrtar, përdorimin e drejtë të resurseve, parandalimin dhe luftimin e mashtrimit, promovimin e meritokracisë në rekrutim dhe zhvillim në karrierë, etj.

Ndjekja e parimeve themelore të përcaktuara me ligj dhe mishërimi me vlerat etike sigurojnë një rrugëtim të suksesshëm dhe të garantuar në përmbushje të synimeve strategjike dhe misionit. Në këtë orientim, IPK ka mbështetjen e partnerëve të brendshëm dhe të jashtëm, që e kanë mbështetur dhe fuqizuar atë në përpjekjet për të garantuar zhvillimin e një policie të përgjegjshme, demokratike dhe profesionale.

Me respekt!

Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv
Inspektorati Policor i Kosovës

Shkurtesat

| | |
|---|---|
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| IPK | Inspektorati Policor i Kosovës |
| ZKA | Zyrtari Kryesor Administrativ |
| ZKE | Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv |
| KE | Kryeshefi Ekzekutiv |
| PSh | Prokurori i Shtetit |
| ZKF | Zyrtari Kryesor Financiar |
| DH | Departamenti i Hetimeve |
| DI | Departamenti i Inspektimeve |
| DMA | Departamenti për Menaxhimin e Ankesave |
| DPBÇLI | Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim |
| DFSHP | Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme |
| DBNJ | Divizioni i Burimeve Njerëzore |
| DBF | Divizioni për Buxhet dhe Financa |
| DTI | Divizioni për Teknologji Informative |
| ZPP | Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit |

**HYRJE**

Ky dokument paraqet Planin e Integritetit të hartuar nga Inspektorati Policor i Kosovës me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të cilat rrjedhin nga nenit 25 i Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Plani i Integritetit paraqet dokumentin i cili përgatitet si rezultat i vetë-vlerësimit të institucionit të ekspozimit të rrezikut të pranisë dhe zhvillimit të korrupsionit dhe ekspozimit ndaj veprimeve të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit është dokument i brendshëm tre (3) vjeçar, që përcakton vlerësimin e rrezikut të korrupsionit dhe formave tjera që e cenojnë integritetin, si dhe masat parandaluese. Si i tillë, Plani shërben për identifikimin e rreziqeve, analizën dhe vlerësimin e rrezikut dhe specifikon masat, sipas rreziqeve për arritjen e objektivave të saj të integritetit, për të avancuar performancën e integritetit brenda organizatës si dhe fuqizimin e sundimit të ligjit dhe vlerave e standardeve profesionale. Plani i Integritetit duhet shqyrtuar në mënyrë periodike dhe të aktualizohet në pajtueshmëri me zhvillimet relevante normative, institucionale dhe procedurale.

Metodologjia për hartimin e këtij dokumenti është në përputhje të plotë me vendimin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit me nr. 1476/23 të datës 26.07.2023 për miratimin e metodologjisë për planet e integritetit. Me këtë rast për identifikimin dhe vlerësimin e fushave të rrezikut janë zhvilluar intervistat me punonjësit në pozitat udhëheqëse brenda Inspektoratit Policor të Kosovës por edhe me punonjësit e tjerë pa pozita udhëheqëse. Më tutje është zhvilluar pyetësori ku kanë pasur mundësinë që të marrin pjesë të gjithë punonjësit në IPK. Rezultatet e pyetësorit dhe intervistave janë shqyrtuar me kujdes nga grupi punues. Të dhënat e mbledhura në këtë formë janë analizuar në kontekst të metodologjisë krahasimore, statistikore dhe empirike ndërsa rezultatet e tyre janë pasqyruar përmes matricave dhe tabelave sipas metodologjisë së miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përmes vendimit të sipërcituar.

Qëllimi i Planit të Integritetit është që të mundësoj realizimin e qëllimeve si në vijim:

- Identifikimi i proceseve të ndjeshme ndaj sjelljeve/veprimeve potencialisht korruptive;
- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion, që synon respektimin e kërkesave ligjore, procedurale dhe kuadrit të brendshëm normativ;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë për të siguruar rritjen e besueshmërisë publike në qeverisjen dhe në performancën e integritetit të sektorit publik;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit, përmes përmirësimit të kontrolleve operacionale në fushat e funksionimit të institucionit dhe proceset e punës me rrezik korrupsioni;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion, me fokus në fushat me rrezik të lartë të cenimit të integritetit.

## 1. PËR INSPEKTORATIN POLICOR TË KOSOVËS

Inspektorati Policor i Kosovës është institucion ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e pavarur tërësisht nga Policia e Kosovës.

Inspektorati Policor i Kosovës funksionon nën autoritetin e Ministrit të Punëve të Brendshme dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës. Autoriteti i ministrit nuk përfshinë menaxhimin operacional të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.

Inspektorati Policor i Kosovës e ka buxhetin e vet mirëpo si vijë buxhetore përbrenda buxhetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe është objekt auditimi. Kryeshefi Ekzekutiv në Inspektoratin Policor të Kosovës është përgjegjës për menaxhimin efektiv dhe të drejtë të buxhetit.

Objekt i veprimtarisë së Inspektoratit Policor të Kosovës është:

- parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ose jashtë detyrës;
- inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në dispozitave juridike në fuqi;
- hetimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë të punonjësve në Policinë e Kosovës;
- hetimi i shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv;
- pranimi dhe trajtimi i të gjitha ankesave të qytetarëve.

Inspektorati Policor i Kosovës udhëhiqet nga parimet e profesionalizmit, objektivitetit, paanshmërisë politike dhe mos diskriminimit. Inspektorati Policor i Kosovës e reflekton përbërjen multietnike të Republikës së Kosovës së bashku me parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut të garantuara më Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës duhet të respektojnë Kodin e Etikës dhe parimet që parashihen me Kodin e Mirësjelljes për Nëpunësit Civil. Në përmbushje të detyrave të tyre, ata duhet të respektojnë ligjin në fuqi, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Procedurat dhe marrja e vendimeve nga Inspektorati Policor i Kosovës duhet të jetë e hapur dhe transparente, përveç nëse kjo do të rrezikojë apo pengojë rrjedhën e hetimeve. Inspektorati Policor i Kosovës duhet t'i zhvillojnë hetimet e tyre në mënyrë të saktë dhe të shpejtë, në pajtim të plotë me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.

## 2. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE

Në përputhje me ligjin fuqi për Inspektoratin Policor të Kosovës, mandati dhe kompetencat themelore manifestohen përmes tri (3) funksioneve kryesore të cilat janë hetimet penale dhe disiplinore në raste të caktuara me ligj, pastaj inspektimi i fushave dhe strukturave në policinë e Kosovës, si dhe pranimi i ankesave nga të gjitha palët pavarësisht statusit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në funksion të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga këto kompetenca ligjore, në Inspektoratin Policor të Kosovës ekzistojnë burimet njerëzore profesionale, buxheti përkatës si dhe ofrohen shërbimet e nevojshme nga fusha e teknologjisë informative.

Në vijim identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve është klasifikuar në dy (2) fusha kryesore të cilat janë fushat e përbashkëta të rrezikut dhe fushat specifike të rrezikut.

Si fusha të përbashkëta të rrezikut nënkuptohen të gjitha rreziqet potenciale për përfshirjen e punonjësve në korrupsion që ndërlidhen me aspektin e burimeve njerëzore, buxhetin e IPK-së apo aspektin e teknologjisë informative.

Si fusha specifike të rrezikut duhet të nënkuptohen të gjitha rreziqet potenciale për përfshirjen në korrupsion të punonjësve operativ (hetuesve dhe inspektorëve) të Inspektoratit Policor të Kosovës. Pra në kuadër të fushave specifike të rrezikut janë evidentuar rreziqet kryesore potenciale që ndërlidhen me funksionin e hetimeve penale dhe disiplinore në rastet e caktuara me ligj, pastaj me funksionin e inspektimeve në Policinë e Kosovës por edhe me funksionin për pranimin dhe menaxhimin e ankesave që pranohen në Inspektoratin Policor të Kosovës.

### 2.1. FUSHAT E PËRBASHKËTA TË RREZIKUT

Lidhur me fushat e përbashkëta të rrezikut, përmes metodologjisë së përdorur me rastin e hartimit të këtij dokumenti janë evidentuar gjithsej pesë (5) rreziqe kryesore. Në vijim janë prezantuar cili prej këtyre rreziqeve të identifikuara së bashku me rezultatet respektivisht të gjeturat e vlerësimit të tyre nga grupi punues.

**Pasaktësia e të dhënave në raportet e punës dhe dokumentet tjera zyrtare të IPK-së:** IPK krijon dhe përpunon në vazhdimësi të dhëna në funksion të misionit të saj. Raportet e IPK-së përmbajnë një numër të madh të dhënash që pasqyrojnë aktivitetet e saj në hetimin e veprave penale, inspektimin e strukturave dhe funksioneve policore dhe menaxhimin e fondeve dhe burimeve tjera. Këto të dhëna në shenjë transparence publikohen dhe publiku ka interes të njihet me to. Rezultatet e anketës pasqyrojnë se ekziston **rrezik i mesëm** që të dhënat e tilla të jenë të pasakta. Edhe pse IPK-ja ka filtra të mjaftueshëm që e pamundësojnë rrjedhjen e pasaktësive të të dhënave, rrjedhja eventuale e tyre mund të paraqes shqetësim për publikun dhe rënie të besueshmërisë. IPK nuk

duhet të neglizhoj këtë rrezik dhe nëse nuk tejkalohet mund të ketë ndikim të dëmshëm në reputacion. Rreziku mund të tejkalohet me kontrolle serioze dhe të programuara të mënyrës së përpunimit të të dhënave. Në fushën e inspektimit duhet pasur kujdes që të dhënat e pranuara nga struktura policore, të jenë të besueshme, të qëndrueshme dhe të marra nga kuadro kompetente. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab. 1. Pasaktësia e të dhënave në raportet e punës dhe dokumentet tjera zyrtare të IPK-së**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pasojat/Ndikimi | Madhor | 10 | | | | | | | | | | |
| | | 9 | | | | | | | | | | |
| | | 8 | | | | | | | | | | |
| | Mesatar | 7 | | | | | | | | | | |
| | | 6 | | | | | | | | | | |
| | | 5 | | | | | | | | | | |
| | | 4 | | | | | | | | | | |
| | Vogël | 3 | | | | | | | | | | |
| | | 2 | | | | | | | | | | |
| | | 1 | | | | | | | | | | |
| **Intensiteti i rrezikut (gjasat x ndikimi)** | | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| | | | Ulët | | | Mesatar | | | | Lartë | | |
| | | | Probabiliteti/Gjasat | | | | | | | | | |

**Mosrespektimi i parimit të meritokracisë gjatë procedurave të rekrutimit dhe zhvillimit në karrierë:** Burimet njerëzore të IPK-së paraqesin investimin me koston më të lartë brenda organizatës. Duke qenë vlera të organizatës, burimet njerëzore ndikojnë në kryerjen cilësore të detyrave në shërbim të publikut. Përmbushja e mandatit të IPK-së kërkon njohuri dhe shkathtësi të personelit dhe për këtë organizata interesohet të rekrutoj punonjës me afinitete në fushën e sigurisë dhe kontrollit. Procesi i rekrutimit, por edhe ai i zhvillimit në karrierë duhet të ndjek rregullat dhe procedurat e përcaktuara, duke marrë për bazë kriterin e meritokracisë. Rezultatet e anketës pasqyrojnë se ekziston **rrezik i mesëm** që të mos respektohet parimi i meritokracisë. IPK-ja edhe pse ka akte ligjore e nënligjore mbi marrëdhënien e punës që rregullojnë proceset e rekrutimit/zhvillimit në karrierë, mos përmbushja e parimit të meritokracisë mund të siguroj kuadro jocilësore, që nuk sigurojnë cilësi dhe seriozitet në kryerjen e detyrave. Po ashtu, kjo mund të ketë për pasojë rënien e besimit tek qytetarët dhe tek të interesuarit për t'u bërë pjesë e organizatës. Ky rrezik mund të tejkalohet me kontrolle serioze në respektimin e procedurave të konkurrimit, por edhe angazhimin e komisioneve me integritet, që sigurojnë se proceset do të jenë të pandikuara. Neglizhimi i këtij rreziku mund të ndikojë dëmshëm dhe në periudhë afatgjatë, që mund të sjellë në pikëpyetje edhe misionin e organizatës. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab. 2. Mosrespektimi i parimit të meritokracisë gjatë procedurave të rekrutimit dhe zhvillimit në karrierë**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pasojat / Ndikimi | Madhor | 10 | | | | | | | | | | |
| | | 9 | | | | | | | | | | |
| | | 8 | | | | | | | | | | |
| | Mesatar | 7 | | | | | | | | | | |
| | | 6 | | | | | | | | | | |
| | | 5 | | | | | | | | | | |
| | | 4 | | | | | | | | | | |
| | Vogël | 3 | | | | | | | | | | |
| | | 2 | | | | | | | | | | |
| | | 1 | | | | | | | | | | |
| Intensiteti i rrezikut (gjasat x ndikimi) | | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| | | | Ulët | | | Mesatar | | | | Lartë | | |
| | | | Probabiliteti/Gjasat | | | | | | | | | |

**Kujdesi jo i duhur ndaj aseteve/pasurisë së organizatës:** IPK-ja ka besimin e shtetit dhe qytetarëve të saj të sigurojë një polici të përgjegjshme, demokratike dhe profesionale. Marrja e këtij besimi përveç se paraqet një privilegj, po ashtu ngritë përgjegjësinë që IPK-ja të ushtroj kompetencat e saj me integritet dhe efikasitet të lartë. Në përmbushje të mandatit IPK-së i janë besuar fonde dhe pasuri, pa të cilat nuk mund të realizohen aktivitetet operative. Pajisjet, automjetet, armët, objektet dhe pasuritë tjera kërkojnë që të kihet kujdes në mënyrën e shfrytëzimit të tyre. Keqpërdorimi i pasurive përbën vepër penale dhe kjo nxitë titullarin që të ushtroj kontrolle mbi mënyrën e shfrytëzimit të tyre. Rezultatet e anketës pasqyrojnë se ekziston **rrezik i mesëm** që të ketë kujdes jo të duhur ndaj pasurive. Edhe pse organizata ka mekanizma dhe instrumente që synojnë parandalimin e keqpërdorimit të pasurive, nuk mund të thuhet se nuk është i mundur keqpërdorimi i tillë. Ky rrezik tejkalohet nëse ka auditime më të shpeshta, procese të rregullta të inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive, inspektime ad hoc dhe të paparalajmëruara, etj. Neglizhimi i këtij rreziku bartë me vete dëme të pariparueshme, humbje financiare, humbje investimesh, largim të partnerëve, mos besueshmëri tek policia dhe palët tjera, etj. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab. 3. Kujdesi jo i duhur ndaj aseteve/pasurisë së organizatës**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pasojat / Ndikimi | Madhor | 10 | | | | | | | | | | |
| | | 9 | | | | | | | | | | |
| | | 8 | | | | | | | | | | |
| | Mesatar | 7 | | | | | | | | | | |
| | | 6 | | | | | | | | | | |
| | | 5 | | | | | | | | | | |
| | | 4 | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Vogël | 3 | | | | | | | | | | |
| | | 2 | | | | | | | | | | |
| | | 1 | | | | | | | | | | |
| Intensiteti i rrezikut (gjasat x ndikimi) | | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| | | | Ulët | | | Mesatar | | | | Lartë | | |
| | | | Probabiliteti/Gjasat | | | | | | | | | |

**Mosrespektimi i parimeve themelore të prokurimit publik lidhur me kontratat e arritura me operatorët ekonomik:** IPK ka të ndara fonde në funksion të pagesave të kontratave për furnizime, shërbime dhe punë. Këto fonde në besim, të ofruara nga buxhetit i shtetit duhet shpenzuar duke u bazuar në ligjet, që kërkojnë që ato të shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe ekonomike. Anketa pasqyron se ekziston **rrezik i mesëm** që të mos respektohen parimet themelore të prokurimit publik lidhur me kontratat me operatorët ekonomik. Lufta kundër korrupsionit kërkon minimizimin e mundësive për keqpërdorim të fondeve dhe IPK duhet të jetë e kujdesshme në këtë drejtim, meqë edhe vetë konsiderohet si akter me rëndësi në këtë sfidë. Nga IPK-ja kërkohet që të jetë e kujdesshme dhe shembull i promovimit të keqpërdorimit të financave publike. Janë disa parakushte që minimizojnë mundësitë për mosrespektim të parimeve të prokurimit, për shkak se IPK-ja ka të konsoliduar kontrollin e brendshëm financiar dhe prokurues, prokurimet e saj i nënshtrohen rregullave të transparencës së brendshme e të jashtme dhe se divizioni përkatës i prokurimit ka personel të certifikuar. Ky rrezik mund të tejkalohet me rishikim të vazhdueshëm të respektimit të rregullave dhe procedurave të aktiviteteve të prokurimit, trajnimin e vazhdueshëm të personelit, etj. Neglizhimi i këtij rreziku mund të ndikojë dëmshëm për një periudhë afatgjatë dhe sjellë në pikëpyetje reputacionin e organizatës. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab.4. Mosrespektimi i parimeve themelore të prokurimit publik lidhur me kontratat e arritura me operatorët ekonomik**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pasojat / Ndikimi | Madhor | 10 | | | | | | | | | | |
| | | 9 | | | | | | | | | | |
| | | 8 | | | | | | | | | | |
| | Mesatar | 7 | | | | | | | | | | |
| | | 6 | | | | | | | | | | |
| | | 5 | | | | | | | | | | |
| | | 4 | | | | | | | | | | |
| | Vogël | 3 | | | | | | | | | | |
| | | 2 | | | | | | | | | | |
| | | 1 | | | | | | | | | | |
| Intensiteti i rrezikut (gjasat x ndikimi) | | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| | | | Ulët | | | Mesatar | | | | Lartë | | |
| | | | Probabiliteti/Gjasat | | | | | | | | | |

**Keqmenaxhimi i financave publike që i janë besuar organizatës në funksion të aktiviteteve të saj:** IPK ka konsoliduar kontrollin e brendshëm financiar, që përfshinë një varg masash në shpenzimin e parasë publike. Transaksionet financiare janë objekt i vazhdueshëm i kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimeve të rregullta të brendshme dhe të jashtme. IPK në funksion të aktiviteteve të saj ka në dispozicion edhe fonde të fshehta, që mbulojnë shpenzimet në rrafsh operativ. Anketa pasqyron se ekziston **rrezik i mesëm** që të keqmenaxhohen financat në funksion të aktiviteteve të IPK-së. Edhe pse janë disa parakushte që minimizojnë mundësitë për keqpërdorim të financave, për shkak se shpenzimi i tyre i nënshtrohet rregullave e procedurave të kontrollit të brendshëm, transaksionet ushtrohen nga punonjës kompetent e të përgatitur, megjithatë duhet ndërmarrë veprime vet kontrolli. Ky rrezik mund të tejkalohet me kontrolle të vazhdueshme, trajnim të vazhdueshëm të personelit, etj. Neglizhimi i këtij rreziku mund të ndikojë dëmshëm në periudhë afatgjatë dhe të sjellë në pikëpyetje reputacionin. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab.5. Keqmenaxhimi i financave publike që i janë besuar organizatës në funksion të aktiviteteve të saj**



## 2.2. FUSHAT SPECIFIKE TË RREZIKUT

Lidhur me fushat e specifike të rrezikut, përmes metodologjisë së përdorur me rastin e hartimit të këtij dokumenti janë evidentuar gjithsej pesëmbëdhjetë (15) rreziqe kryesore. Në vijim janë prezantuar cili prej këtyre rreziqeve të identifikuara së bashku me rezultatet respektivisht të gjeturat e vlerësimit të tyre nga grupi punues.

**Paqëndrueshmëria e evidencës së të dhënave për shkak të mungesës së një data baze unike:** IPK mbanë evidencë mbi ankesat dhe rastet në hetim penal. Të dhënat mbi lëndët mbahen në evidenca të ndara dhe nuk janë të integruara. Një pjesë e tyre që lidhen me ankesat administrohen nga Departamenti i Menaxhimit të Ankesave në formë fizike dhe në excel. Pjesa tjetër që lidhet me hetimet penale administrohet nga Departamenti i Hetimeve në formë fizike dhe elektronike. Administrimi efikas i evidencave sfidohet nga mungesa e një baze unike të dhënash që do të integronte të gjitha të dhënat e nevojshme mbi rastet. IPK vetëm se ka në planet e saj të sigurojë një bazë të tillë, që do të gjeneronte tërë informacionin mbi numrin e rasteve dhe statusin e tyre, por edhe do të ofronte raporte sipas kërkesave të menaxhmentit. Rezultatet e anketës pasqyrojnë se ekziston **rrezik i mesëm** që evidencat e të dhënave të jenë të paqëndrueshme për shkak të mungesës së një data baze unike. Edhe pse IPK ka programe të evidentimit të rasteve, me të cilat administron personeli i kualifikuar, nevoja për avancimin e evidencave është imperativ. IPK-ja nuk duhet të neglizhoj këtë rrezik dhe nëse ai nuk tejkalohet, mund të ndikojë në reputacion por edhe krijon mbingarkesë në mirëmbajtjen e evidencave. Rreziku mund të tejkalohet nëse sigurohet baza elektronike e të dhënave, ku do të administroheshin veç të dhënave mbi hetimet, inspektimet, edhe analizat dhe informatat inteligjente. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab.6.Paqëndrueshmëria e evidencës së të dhënave për shkak të mungesës së një data baze unike**



**Pasqyrimi jo objektiv i gjetjeve në raportet e inspektimit:** IPK-ja ka mandat të kryejë inspektimin e strukturave dhe funksioneve policore dhe i gjithë ky aktivitet rezulton me raporte, të cilat i atribuohen gjetjeve dhe iu ofrohen menaxhmentit policor, Ministrit, por edhe publikut. Është me rëndësi që gjetjet e inspektimit të pasqyrohen në mënyrë objektive dhe të përmbushin objektivat e inspektimit. Përmes raportimit, publiku njihet me aktivitetet e Policisë dhe përmes rekomandimeve synohet të përmirësohet performanca policore. Inspektimi dhe raportimi duhet të jetë i paanshëm, në mënyrë që jenë të besueshme. Anketa ka pasqyruar se ekziston një **rrezik i mesëm** që gjetjet në raportet e inspektimit të pasqyrohen në mënyrë jo objektive. Edhe pse IPK-ja ka mekanizma që i aktivizon në disa nivele të kontrollit të punës inspektuese dhe raportimit, duhet të kihen parasysh kontrolle cilësore të punës në terren, mostrim adekuat, fokus në pikat e ndjeshme, si dhe përcjellje e vazhdueshme e cilësisë së raportimit. Ky rrezik mund të tejkalohet me mbikëqyrje dhe kontrolle të vazhdueshme të mënyrës së trajtimit të dokumenteve, aplikimit të ekspertizës adekuate dhe fokusimit tek materialet që detektojnë pikat e dobëta të performancës policore. Neglizhimi i këtij rreziku krijon një vetëkënaqësi të tepruar, mos detektim të problemeve që ekzistojnë në organizatën policore, fshehje dhe vazhdim të performancës së dobët policore. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab.7. Pasqyrimi jo objektiv i gjetjeve në raportet e inspektimit**




**Mosinicimi i aktiviteteve të inspektimit apo hetimeve penale për çështjet që ka interes publiku:** Bazuar në legjislacionin aktual, ndër kompetencat e komponentës hetimore dhe inspektuese të IPK-së është edhe parandalimi i keqpërdorimeve apo veprave penale. Bazuar në kompetencat e saj, IPK ka përkushtimin dhe gatishmërinë që për të gjitha informatat që posedon, të shfrytëzoj instrumentet e saj, qoftë të hetimit apo inspektimit për t'i dhënë fokusin e duhur ngjarjeve apo shqetësimeve të publikut, të lidhura me sjelljet e pahijshme të policisë. Tashmë informacionet mbi sjelljet e pahijshme policore

shpërndahen shpejt falë konsolidimit të formave të denoncimit në IPK, bashkëpunimit policor, por edhe zhvillimit të teknologjisë informative. Anketa pasqyron se ekziston **rrezik i mesëm** që të mos iniciohen aktivitete të inspektimit dhe hetimit penal për çështjet që ka interes publiku. Edhe pse ka instrumente që i mundësojnë IPK-së aktivitetin parandalues në çështjet e ngritura dhe në interes të publikut, duhet të ketë angazhime të shtuara sa i përket zhvillimit të një policie të përgjegjshme dhe eliminimit të elementëve që prishin imazhin e Policisë. Ky rrezik tejkalohet nëse ka një përkushtim të vazhdueshëm të strukturës hetimore dhe asaj inspektuese në rrafshin parandalues, duke përdorur informacionet mbi çështjet e ngritura por edhe informatat inteligjente nga burime të ndryshme. Neglizhimi i këtij rreziku mund të krijoj përshtypjen sikur IPK-ja nuk interesohet për shqetësimet e qytetarëve, humb besimin dhe krijon dyshime që ka ndërhyrje me elemente korruptive. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab.8. Mosinicimi i aktiviteteve të inspektimit apo hetimeve penale për çështjet që ka interes publiku**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pasojat / Ndikimi | Madhor | 10 | | | | | | | | | | |
| | | 9 | | | | | | | | | | |
| | | 8 | | | | | | | | | | |
| | Mesatar | 7 | | | | | | | | | | |
| | | 6 | | | | | | | | | | |
| | | 5 | | | | | | | | | | |
| | | 4 | | | | | | | | | | |
| | Vogël | 3 | | | | | | | | | | |
| | | 2 | | | | | | | | | | |
| | | 1 | | | | | | | | | | |
| Intensiteti i rrezikut (gjasat x ndikimi) | | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| | | | Ulët | | | Mesatar | | | | Lartë | | |
| | | | Probabiliteti/Gjasat | | | | | | | | | |

**Mos ndërmarrja me kohë e veprimeve hetimore:** Suksesi i një hetimi në masë të madhe varet edhe nga shpejtësia e ndërmarrjes së veprimeve. Është e kuptueshme që mund të ketë ngarkesë të hetuesve me numër të madh të lëndëve, por duhet pasur kujdes që procesi hetimor të mund të kryhet në një kohë optimale. Çdo zhagitje në ndërmarrjen e veprimeve hetimore rrezikon humbjen e provave, humb interesimin e dëshmitarëve për të kontribuuar në hetimin e suksesshëm të rasteve dhe humb besimin tek palët në përmbushjen me sukses të misionit të IPK-së. Anketa pasqyron se ekziston një **rrezik i mesëm** në ndërmarrjen me kohë të veprimeve hetimore. Ky rrezik tejkalohet me racionalizim të kohës së punës, ndarjen proporcionale të rasteve për hetues, prioritetizimin e rasteve dhe ngritjen e kontrolleve menaxheriale mbi hetuesit për t'u siguruar se rastet hetohen me kohë. Mos ndërmarrja me kohë e veprimeve rrezikon

humbjen e provave, humbjen e dëshmitarëve, humb besimin dhe krijon dyshime për ndërhyrje me elementë korruptiv. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab.9. Mos ndërmarrja me kohë e veprimeve hetimore**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pasojat / Ndikimi | Madhor | 10 | | | | | | | | | | |
| | | 9 | | | | | | | | | | |
| | | 8 | | | | | | | | | | |
| | Mesatar | 7 | | | | | | | | | | |
| | | 6 | | | | | | | | | | |
| | | 5 | | | | | | | | | | |
| | | 4 | | | | | | | | | | |
| | Vogël | 3 | | | | | | | | | | |
| | | 2 | | | | | | | | | | |
| | | 1 | | | | | | | | | | |
| Intensiteti i rrezikut (gjasat x ndikimi) | | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| | | | Ulët | | | Mesatar | | | | Lartë | | |
| | | | Probabiliteti/Gjasat | | | | | | | | | |

**Prezantimi i gabuar apo mos prezantimi i fakteve relevante te Prokurori kompetent lidhur me rastet penale:** Është e njohur se hetuesit punojnë nën autorizimet që ua jep Prokurori i Shtetit. Hetimet fillojnë me aktvendim mbi hetimin dhe hetuesit obligohen të njoftojnë Prokurorin mbi rrjedhën e hetimeve. Për një hetim të suksesshëm nevojitet bashkëpunim i ngushtë Prokurori-Polici. Suksesi i hetimit varet nga ajo se si hetuesit i transmetojnë faktet para këtij autoriteti dhe kjo nënkupton se Prokurori duhet të ketë informacion jo të shtrembëruar nga hetuesit. Anketa pasqyron se ka një **rrezik të mesëm** që tek Prokurori kompetent të bëhen prezantime të gabuara nga ana e hetuesve apo mos prezantim i fakteve relevante lidhur me rastet. Edhe pse vlerësohet se ka mekanizma kontrolli që synojnë të eliminojnë këto situata, ushtrimi i kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit do të rriste shkallën e sigurisë për prokurorët dhe IPK-në se hetuesit janë duke bërë gjënë e duhur në komunikimin me prokurorët. Neglizhimi i këtij rreziku rrezikon proceset të drejta hetimore, devijon proceset hetimore, rrezikon bashkëpunimin me Prokurorin e Shtetit, humb besimin tek palët dhe rrezikon misionin e IPK-së. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab.10. Prezantimi i gabuar apo mos prezantimi i fakteve relevante te Prokurori kompetent lidhur me rastet penale**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pasojat / Ndikimi | Madhor | 10 | | | | | | | | | | |
| | | 9 | | | | | | | | | | |
| | | 8 | | | | | | | | | | |
| | Mesatar | 7 | | | | | | | | | | |
| | | 6 | | | | | | | | | | |
| | | 5 | | | | | | | | | | |
| | | 4 | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Vogël | 3 | | | | | | | | | | |
| | | 2 | | | | | | | | | | |
| | | 1 | | | | | | | | | | |
| Intensiteti i rrezikut (gjasat x ndikimi) | | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| | | | Ulët | | | Mesatar | | | | Lartë | | |
| | | | Probabiliteti/Gjasat | | | | | | | | | |

**Intervistimi i të dyshuarve dhe dëshmitarëve nga vetëm një hetues për rast:** Intervistimi i palëve me vetëm një hetues nuk paraqet praktika të mira në fushën e hetimeve. Prezenca e vetëm një hetuesi nuk siguron se intervista do të jenë cilësore dhe gjithëpërfshirëse. Mund të ngritën dyshime që nuk prezantohen të gjitha faktet që mund të shpijnë në zbulimin e rastit dhe rasti mund të marrë drejtim të gabuar drejt dështimit të mundshëm të tij. Përfshirja edhe e hetuesit të dytë rritë gjasat për intervistë kualitative. Anketa pasqyron **rrezik të mesëm** nëse intervistat me palët kryhen me vetëm një hetues për rast. Numri i madh i lëndëve dhe numri jo i mjaftueshëm mund të jenë faktorë ndikues për të ardhur në shprehje këto situata. Shtimi i numrit të hetuesve do të reduktonte rastet e intervistave me vetëm një hetues. Neglizhimi i këtij rreziku mund të rrisë gjasat për intervista jo cilësore, devijim të proceseve hetimore dhe ndikime nga jashtë. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab.11. Intervistimi i të dyshuarve dhe dëshmitarëve nga vetëm një hetues për rast**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pasojat / Ndikimi | Madhor | 10 | | | | | | | | | | |
| | | 9 | | | | | | | | | | |
| | | 8 | | | | | | | | | | |
| | Mesatar | 7 | | | | | | | | | | |
| | | 6 | | | | | | | | | | |
| | | 5 | | | | | | | | | | |
| | | 4 | | | | | | | | | | |
| | Vogël | 3 | | | | | | | | | | |
| | | 2 | | | | | | | | | | |
| | | 1 | | | | | | | | | | |
| Intensiteti i rrezikut (gjasat x ndikimi) | | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| | | | Ulët | | | Mesatar | | | | Lartë | | |
| | | | Probabiliteti/Gjasat | | | | | | | | | |

**Rrjedhja e informacioneve zyrtare te palët e paautorizuara**: Suksesi i hetimeve dhe inspektimeve në masë të madhe varet edhe nga ruajtja e konfidencialitetit. Personeli i IPK-së ka të nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit, si parakusht për ushtrim të denjë të kompetencës. Informacionet e zbuluara në mënyrë të paautorizuar për ndonjë hetim apo inspektim rrezikon humbjen dhe fshehjen e provave, arratisjen e të dyshuarve, etj. IPK ka ndërmarrë disa veprime në drejtim të ruajtjes së informacionit, por nuk duhet

krijuar perceptimi se masat e tilla janë të mjaftueshme. Anketa pasqyron se ekziston **rrezik i mesëm** që të ketë rrjedhje të informatave te palët e paautorizuara. Aktiviteti i sinjalizuesve konsiderohet i mirëseardhur në reduktimin e mundësive për të zbuluar informatat në mënyrë të paautorizuar. Denoncimi i personave të dyshuar tek prokurori mbi zbulimin e paautorizuar të informatave mund të jetë formë e ruajtjes së konfidencialitetit. Shpërndarja e informacionit te një numër i kufizuar punonjësish mund të jetë po ashtu një masë efikase në ruajtjen e konfidencialitetit. Neglizhimi i këtij rreziku rritë gjasat për dështim të proceseve hetimore, dështimin e operacioneve të arrestimit, krijon mosbesim te informatorët dhe palët tjera, rrezikon reputacionin dhe vë në mëdyshje misionin. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab.12. Rrjedhja e informacioneve zyrtare te palët e paautorizuara**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pasojat / Ndikimi | Madhor | 10 | | | | | | | | | | |
| | | 9 | | | | | | | | | | |
| | | 8 | | | | | | | | | | |
| | Mesatar | 7 | | | | | | | | | | |
| | | 6 | | | | | | | | | | |
| | | 5 | | | | | | | | | | |
| | | 4 | | | | | | | | | | |
| | Vogël | 3 | | | | | | | | | | |
| | | 2 | | | | | | | | | | |
| | | 1 | | | | | | | | | | |
| Intensiteti i rrezikut (gjasat x ndikimi) | | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| | | | Ulët | | | Mesatar | | | | Lartë | | |
| | | | Probabiliteti/Gjasat | | | | | | | | | |

**Mospranimi i ankesës pavarësisht natyrës së saj nga ana e zyrtarit përgjegjës në IPK:** Sipas ligjit në fuqi, IPK pranon çdo ankesë të qytetarëve nën dyshimin për sjellje të pahijshme policore. IPK-ja duhet të pranojë ankesat nga qytetarët kur ata insistojnë ta bëjnë atë. IPK ka Departamentin i cili trajton të gjitha ankesat lidhur me dyshimet për përfshirje policore në vepra të kundërligjshme. IPK ofron shumë mundësi për qytetarët për të parashtruar ankesë dhe kjo paraqet një të drejtë të garantuar. Anketa pasqyron se ka **rrezik të mesëm** që zyrtarët përgjegjës të mos pranojnë ankesa nga palët. Edhe pse ka një përkushtim të personelit që të trajtojnë çdo ankesë të ardhur, çdo angazhim i vazhdueshëm në adresimin e shqetësimeve të qytetarëve, i siguron ata se shqetësimet e tyre merren parasysh dhe se IPK është në shërbim të tyre. Kontrolli i vazhdueshëm i punës së hetuesve në pranimin e ankesave redukton gjasat për shkelje të një të drejte të garantuar. Neglizhimi i këtij rreziku humb besimin tek qytetarët dhe i demotivon ata në denoncimin e shkeljeve dhe ngritë dyshimet për fshehje të rasteve dhe rehabilitim të të

dyshuarve. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab.13. Mospranimi i ankesës pavarësisht natyrës së saj nga ana e zyrtarit përgjegjës në IPK**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pasojat / Ndikimi | Madhor | 10 | | | | | | | | | | |
| | | 9 | | | | | | | | | | |
| | | 8 | | | | | | | | | | |
| | Mesatar | 7 | | | | | | | | | | |
| | | 6 | | | | | | | | | | |
| | | 5 | | | | | | | | | | |
| | | 4 | | | | | | | | | | |
| | Vogël | 3 | | | | | | | | | | |
| | | 2 | | | | | | | | | | |
| | | 1 | | | | | | | | | | |
| Intensiteti i rrezikut (gjasat x ndikimi) | | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| | | | Ulët | | | Mesatar | | | | Lartë | | |
| | | | Probabiliteti/Gjasat | | | | | | | | | |

**Përshkrimi i gabuar (i qëllimshëm) apo mos përshkrimi i të gjitha fakteve të prezantuara nga ankuesi gjatë marrjes së ankesës**: Përshkrimi i gabuar (i qëllimshëm) apo mos përshkrimi i të gjitha fakteve të prezantuara nga ankuesi gjatë marrjes së ankesës mund të ketë për qëllim devijimin e proceseve hetimore dhe epilog jo real të rastit. Hetuesit e IPK-së konsiderohet se kanë trajnime dhe përvojë të mjaftueshme për të minimizuar mundësitë e ndodhjes së këtyre rasteve. Rol pozitiv për intervista cilësore mund të ketë edhe Prokurori i rastit. Anketa pasqyron se mund të ketë **rrezik të mesëm** që të ndodhin këto situata. Ekziston sistem disa shkallësh i kontrollit të mënyrës së marrjes së ankesave, i ushtruar nga Udhëheqësit e divizioneve, Udhëheqësit e Departamenteve, Kryeshefi Ekzekutiv dhe Prokurori i Shtetit, që në masë të madhe pamundëson përshkrimin jo të duhur të fakteve gjatë marrjes së ankesës. Ky kontroll duhet të jetë i vazhdueshëm drejt ngritjes së cilësisë së ankesave. Neglizhimi i këtij rreziku dëmton procesin hetimor, humb besimin, demotivon palët ankuese dhe rrezikon misionin. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab.14. Përshkrimi i gabuar (i qëllimshëm) apo mos përshkrimi i të gjitha fakteve të prezantuara nga ankuesi gjatë marrjes së ankesës**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pasojat / Ndikimi | Madhor | 10 | | | | | | | | | | |
| | | 9 | | | | | | | | | | |
| | | 8 | | | | | | | | | | |
| | Mesatar | 7 | | | | | | | | | | |
| | | 6 | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 5 | | | | | | | | | | |
| | | 4 | | | | | | | | | | |
| | Vogël | 3 | | | | | | | | | | |
| | | 2 | | | | | | | | | | |
| | | 1 | | | | | | | | | | |
| Intensiteti i rrezikut (gjasat x ndikimi) | | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| | | | Ulët | | | Mesatar | | | | Lartë | | |
| | | | Probabiliteti/Gjasat | | | | | | | | | |

**Mosrealizimi i hetimit preliminar për të gjitha ankesat e pranuara në IPK:** Departamenti përkatës në IPK ka përgjegjësi dhe kompetencë që të mbledhë informata mbi rastet si pjesë e një hetimi paraprak. Por për shkak të kapaciteteve të kufizuara sasiore të burimeve njerëzore nuk ndodhë që hetimi preliminar të realizohet në masën e duhur. Anketa pasqyron se ekziston **rrezik i mesëm** që të mos realizohet hetimi preliminar. Ky rrezik tejkalohet me shtim të numrit të hetuesve, ku më pas rastet e dërguara në autoritetin përgjegjës për hetim përkatës të jenë më të kristalizuara. Neglizhimi i këtij rreziku shton gjasat që rastet të kthehen dhe të humbet kohë në trajtimin e duhur të tyre. Dërgimi i rasteve për trajtim disiplinor tek autoriteti policor rrezikon kthimin e tyre përsëri në IPK në mungesë të një hetimi paraprak në kohën e duhur. Rezultati i vlerësimit të këtij rreziku potencial është pasqyruar përmes tabelës si në vijim:

**Tab.15. Mosrealizimi i hetimit preliminar për të gjitha ankesat e pranuara në IPK**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pasojat / Ndikimi | | 10 | | | | | | | | | | |
| | Madhor | 9 | | | | | | | | | | |
| | | 8 | | | | | | | | | | |
| | | 7 | | | | | | | | | | |
| | Mesatar | 6 | | | | | | | | | | |
| | | 5 | | | | | | | | | | |
| | | 4 | | | | | | | | | | |
| | | 3 | | | | | | | | | | |
| | Vogël | 2 | | | | | | | | | | |
| | | 1 | | | | | | | | | | |
| Intensiteti i rrezikut (gjasat x ndikimi) | | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| | | | Ulët | | | Mesatar | | | | Lartë | | |
| | | | Probabiliteti/Gjasat | | | | | | | | | |

## 3. MASAT PËR EVITIMIN DHE TEJKALIMIN E RREZIQEVE

Duke u bazuar në rezultatet e identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve të elaburuara në këtë dokument, në vijim janë pasqyruar masat kryesore për parandalimin respektivisht evitimin dhe tejkalimin e rreziqeve. Me këtë rast në tabelë janë të pasqyruara fushat dhe përshkrimi i rrezikut, vlerësimi i rrezikut, masat ekzistuese të kontrollit dhe masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve, njësia përgjegjëse brenda IPK-së si dhe afati i realizimit.

| FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Identifikimi i rrezikut | | | Intensitetit rrezikut | | | | Masat ndaj rrezikut | | |
| Nr. | Fusha e rrezikut | Përshkrimi i Rrezikut | Masat ekzistuese të kontrollit | Gjasat | Ndikimi | Vlerësimi i rrezikut | Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve | Njësia/zyrtari përgjegjës | Afati i realizimit |
| 1 | Përbashkët | Pasaktësia e të dhënave në raportet e punës dhe dokumentet tjera zyrtare të IPK-së | Kontrollet e rregullta nga mbikëqyrësi | Ulët | Mesëm | Mesëm | Rritja e kontrollit nga mbikëqyrësit | Kryeshefi Ekzekutiv dhe Udhëheqësit e Departamenteve | Vazhdimisht |
| 2 | Përbashkët | Mosrespektimi i parimit të meritokracisë gjatë procedurave të rekrutimit dhe zhvillimit në karrierë | Zbatimi i procedurave të rekrutimit dhe zhvillimit në karrierë | Mesëm | Mesëm | Mesëm | Rishikimi i procedurave dhe kritereve për rekrutim dhe zhvillim në karrierë - rritja e kontrollit/auditimit - emërimi i komisioneve me integritet | Kryeshefi Ekzekutiv dhe Menaxheri i Burimeve Njerëzore | Vazhdimisht |
| 3 | Përbashkët | Kujdesi jo i duhur ndaj aseteve/pasurisë së organizatës | Zbatimi i procedurave për menaxhimin e pasurisë dhe aseteve | Mesëm | Mesëm | Mesëm | Rishikimi i procedurave dhe rritja e kontrollit dhe auditimit, inspektime të jashtëzakonshme, invertarizime dhe vlerësime të rregullta | Kryeshefi Ekzekutiv, Udhëheqësit e Departamenteve dhe Zyrtari Përgjegjës i Pasurisë | Vazhdimisht |
| 4 | Përbashkët | Mosrespektimi i parimeve themelore të prokurimit publik lidhur me kontratat e arritura | Zbatimi i procedurave të prokurimit publik | Mesëm | Mesëm | Mesëm | Kontrolle të shtuara dhe trajnim i vazhdueshëm i personelit | Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit | Vazhdimisht |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | me operatorët ekonomik | | | | | | | |
| 5 | Përbashkët | Keqmenaxhimi i financave publike që i janë besuar organizatës në funksion të aktiviteteve të saj | Zbatimi i procedurave të kontrollit të brendshëm | Ulët | Mesëm | Mesëm | Kontrolle të shtuara dhe trajnim i stafit | Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtari Kryesor Financiar | Vazhdimisht |
| 6 | Specifike | Paqëndrueshmëria e evidencës së të dhënave për shkak të mungesës së një data baze unike | Përdorimi i sistemeve ekzistuese të evidencave | Ulët | Mesëm | Mesëm | Krijimi i një databaze unike të IPK-së | Udhëheqësit e Departamenteve dhe Udhëheqësi i Divizionit për Teknologji Informative | Vazhdimisht |
| 7 | Specifike | Pasqyrimi jo objektiv i gjetjeve në raportet e inspektimit | Zbatimi i procedurave të inspektimit dhe raportimit | Ulët | Mesëm | Mesëm | Zbatimi i eksperitzës adekuate dhe rritja e kontrolleve të cilësisë | Kryeshefi Ekzekutiv dhe Udhëheqësi i Departamentit të Inspektimeve | Vazhdimisht |
| 8 | Specifike | Mosinicimi i aktiviteteve të inspektimit apo hetimeve penale për çështjet që ka interes publiku | Zbatimi i procedurave të hetimeve penale, inspektimit dhe raportimit | Ulët | Mesëm | Mesëm | Rritja e aktivitetit në parandalim dhe identifikim të rasteve që duhet inicuar nga IPK | Kryeshefi Ekzekutiv dhe Udhëheqësit e Departamenteve | Vazhdimisht |
| 9 | Specifike | Mos ndërmarrja me kohë e veprimeve hetimore | Ndarja e rasteve te hetuesit dhe menaxhimi i tyre nga mbikëqyrësi | Ulët | Mesëm | Mesëm | Ndarja propocionale e rasteve te hetuesit, prioritizimi i rasteve penale, racionalizimi i kohës në dispozicion si dhe rritja e kontrollit të punës | Udhëheqësi i Departamentit të Hetimeve | Vazhdimisht |
| 10 | Specifike | Prezantimi i gabuar apo mos prezantimi i fakteve relevante | Zbatimi i kontrollit mbi hetuesit nga | Ulët | Mesëm | Mesëm | Rritja e bashkëpunimit ndërmjet IPK dhe prokurisë, rritja e | Udhëheqësi i Departamentit të Hetimeve dhe Udhëheqësi i | Vazhdimisht |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | te Prokurori kompetent lidhur me rastet penale | ana e mbikëqyrësve | | | | mbikëqyrjes së brendshme ndaj hetuesve lidhur me punën e tyre | Departamentit të Ankesave | |
| 11 | Specifike | Intervistimi i të dyshuarve dhe dëshmitarëve nga vetëm një hetues për rast | Zbatimi i kontrollit mbi hetuesit nga ana e mbikëqyrësve | Ulët | Mesëm | Mesëm | Rritja e kapaciteteve njërzore dhe menaxhimi adekuat i burimeve njerëzore ekzistuese | Udhëheqësi i Departamentit të Hetimeve | Vazhdimisht |
| 12 | Specifike | Rrjedhja e informacioneve zyrtare te palët e paautorizuara | Zbatimi i procedurave për mbrojtjen e sinjalizuesve | Ulët | Mesëm | Mesëm | Shpërndarja e kufizuar e informacionit, fuqizimi i sinjalizimit brenda organizatës | Kryeshefi Ekzekutiv dhe Udhëheqësit e Departamenteve | Vazhdimisht |
| 13 | Specifike | Mospranimi i ankesës pavarësisht natyrës së saj nga ana e zyrtarit përgjegjës në IPK | Zbatimi i procedurës për pranimin, menaxhimin dhe administrimin e ankesave | Ulët | Mesëm | Mesëm | Rritja e mbikëqyrjes mbi hetuesit të cilës i pranojnë ankesat - fuqizimi i sinjalizimit brenda organizatës | Udhëheqësi i Departamentit të Ankesave | Vazhdimisht |
| 14 | Specifike | Përshkrimi i gabuar (i qëllimshëm) apo mos përshkrimi i të gjitha fakteve të prezantuara nga ankuesi gjatë marrjes së ankesës | Zbatimi i procedurës për pranimin, menaxhimin dhe administrimin e ankesave | Ulët | Mesëm | Mesëm | Rritja e mbikëqyrjes mbi hetuesit drejt pasqyrimit të shqetësimeve të ankuesve | Udhëheqësi i Departamentit të Ankesave | Vazhdimisht |
| 15 | Specifike | Mosrealizimi i hetimit preliminar për të gjitha ankesat e pranuara në IPK | Zbatimi i pjesëshëm i hetimit preleminar (jo për të gjitha rastet) | Ulët | Mesëm | Mesëm | Rritja e kapaciteteve njërzore dhe menaxhimi adekuat i burimeve njerëzore ekzistuese | Udhëheqësi i Departamentit të Ankesave | Vazhdimisht |